



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2020:184785
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05838965

K.Dh.Sh.II.nr.417/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit V.M., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të kompanisë “MHM Group” sh.p.k., me nr. unik identifikues 810734071, me seli në Xërxë, rr. “Flamuri” p.nr, Rahovec, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Abdullah Hoti me zyre në Prishtinë, kundër debitorit Lorenti-G Sh.p.k me nr. unik identifikues 811168112, me seli në Komoran, Gllogoc me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2406/22 të datës 11.12.2023, me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit V.M., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të kompanisë “MHM Group” sh.p.k, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2406/22 të datës 11.12.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2406/22 të datës 11.12.2023, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2406/22 të datës 11.12.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Lorenti-G Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr.1200/20 të dt. 11.12.2023 të Përmbaruesit Privat Irfan I Kërçaku

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori V.M., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të kompanisë “MHM Group” sh.p.k, me datën 19.11.2020, ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë faturave nr. 08/2019 e datës 11.06.2019 në vlerë prej 2668.25€, faturë nr. 13/2019 e datës 19.07.2019 në vlerë prej 397.80€, faturë nr.16/2019 e datës 28.08.2019 në vlerë prej 29.25€ dhe faturë nr. 17/2019 e datës 18.09.2019 në vlerë prej 1205.10€, duke detyruar debitorin, që në emër të borxhit që rrjedh nga fatura e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 4,300.40€, (katërmijë e treqind euro dhe katër dhjetë cent) me kamatë vonesë 8% e nga dita e lejimit të këtij propozimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat Irfan I Kërçaku me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor 1200/20 të dt. 11.12.2023 e ka lejuar

përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim. Debitori ka paraqitur Prapësim duke kontestuar urdhrin e lejuar për përmbarrim me arsyetimin se mallin e evidentuar në faturën nr. 17/2019 të datës 18.09.2019 nuk e ka pranuar dhe fatura nuk është nënshkruar nga debitori dhe shton se nuk ka autorizuar ndonjë person tjetër për pranimin e mallit të faturës në fjalë. Andaj, nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar ndërsa Urdhri Përmbarrimor P.nr.1200 /20 i datës 19.11.2022 të shfuqizohet. Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk është në pajtueshmëri me nenin 71 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore dhe shton se faturat i përmbajnë të gjitha elementet të cilat duhet t'i përmbaj një dokument i besueshëm. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa Urdhri Përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen e kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaket si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të

LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret gjeti se në propozimin për përmbarim si kreditor paraqitet personi V.M., dhe atë në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të kompanisë MHM Group sh.p.k, ndërsa propozimit për përmbarim, i është bashkangjitur autorizimi për përfaqësim nga i cili rezulton se kreditori V.M., ka autorizuar avokat Avdullah Hoti që ta përfaqësoj të njëjtin në emër dhe për llogarinë e tij personale. Në anën tjetër, në faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi, si kreditor paraqitet subjekti MHM Group sh.p.k dhe jo kreditori i listuar në propozimin për përmbarim, V.M.. Nga të lartcekurat, Gjykata gjen se kreditori V.M. nuk është i autorizuar që të kërkoj realizimin e borxhit sipas faturave mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi në emër dhe për llogarinë e tij personale, kjo për faktin se në këto fatura, si kreditor figuron biznesi MHM Group sh.p.k, i cili subjekt ka personalitet juridik të ndarë dhe është vetvetiu bartëse i të drejtave dhe detyrimeve, kjo në kuptim të nenit 87 të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare me të cilin parashihet se *“Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e të drejtave dhe obligimeve”*.

Pretendimi ankimor të kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturës. Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ndaj, duke u mbështetur në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6 të LPP-së, me të cilin parashihet se prapësimi është i bazuar vetëm nëse *“kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit”*. Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh II.nr.417/24, me datë 20.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri